



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.126, datë 26.05.2022

PËR

**“NDALIMIN E KANDIDIMIT TË KANDIDATIT KRESHNIK AJAZI PËR  
NGRITJEN NË DETYRË NË POZICIONIN E DREJTUESIT TË PROKURORISË  
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TIRANË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 43, 47, 52, 63 dhe 64 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, në nenin 9 pika 2 të Rregullores “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë në pozicionin e drejtuesit në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm”, si dhe në relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

1. Ndalimin e kandidimit të kandidatit, zotin Kreshnik Ajazi, për pozicionin e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimit i bashkëngjitet relacioni shpjegues i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.
3. Të njoftojë zotin Kreshnik Ajazi për këtë Vendim.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga dita e njoftimit të Vendimit.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



KRYETAR  
Alfred Balla

ANËTAR  
Sokol Stojani

ANËTAR  
Bujar Sheshi

ZV/KRYETAR  
Tartar Bazaj

ANËTAR  
Nurihan Seiti



**ANËTAR**  
**Eloida Goxhi**

**ANËTAR**  
**Zeqir Hoda**

**ANËTAR**  
**Esmeralda Keshi**

**ANËTAR**  
**Ludovik Dodaj**

**ANËTAR**  
**Mirela Bogdani**